

Këto Janë Përgjegjësitë Tuaja

Ndërkohë që është detyrimi i Spitalit Saint Vincent dhe stafit tonë për të nderuar dhe respektuar të drejtat tuaja si pacient, ju keni gjithashtu përgjegjësinë që të jepni ndihmën që ta bëni kujdesin tuaj një përvojë shëndeti pozitive dhe të siguronit rezultatet më optimale. Spitali Saint Vincent Hospital pret që ju:

- Të jeni të ndershëm me ne dhe **të jepni informacione të plota dhe të sakta për sëmundjen tuaj aktuale**, përfshirë shtrimet e mëparshme në spital dhe çdo gjë tjetër që dini për shëndetin tuaj që do të na ndihmonte t'ju mjekojmë. Gjithashtu, na tregoni çfarë prisni nga shtrimi në spital dhe mjekimi.
- **Bëni pyetje** për çdo anëtar të stafit tuaj të mjekimit derisa të kenikuptuar **plotësisht** se çfarë po ju thonë; gjithashtu tregojini mjekut tuaj nëse nuk mund të ndiqni planin.
- **Përshtatuni me të gjitha normat dhe rregullat e spitalit** pasi ato lidhen me kujdesin, sigurinë dhe drejtimin tuaj si pacient. Tregoni konsideratë për stafin dhe pronën e Spitalit Saint Vincent si edhe për pacientët e tjerë dhe zotërimet e tyre.
- **Caktoni një autorizim të kujdesit për shëndetin dhe plotësoni një direktivë të avancuar**, në mënyrë që të dimë çfarë lloj kudesi dëshironi të keni në rast se nuk jeni në gjendje të na e tregoni.
- **Jepini spitalit të gjitha informacionet që do tu duhen për të plotësuar me përpikmëri detyrimet tuaja financiare** që do të hasni gjatë kohës që jeni në spital, deri në shkallën e mundësisë tuaj për të paguar.
- **Jini përgjegjës për veprimet tuaja** nëse refuzoni mjekimin mos ndiqni udhëzimet e atyre që ofrojnë kujdesin shëndetësor.

Këto Rregulla Aplikohen për të Dy, Pacientët dhe Vizitorët

- **Respekti të drejtat e pacientëve të tjerë** për të marrë kujdes mjekësor pa u shqetësuar. Telefonat dhe televizorët duhen përdorur në një mënyrë që është e pranueshme për shokun/shoqen e dhomës.
- **Shmanguni përdorimit të telefonave celularë** në zona të kujdesit për pacientë dhe vini re **tabelën ndalohet duhani**.
- **Fotografia: Për shkak të shqetësimit tonë për privatësinë e të gjithë pacientëve, bërja e fotografive në vendet e kujdesit për pacientin është e ndaluar.** Kjo përfshin përdorimin e kamerave të celularëve dhe të gjitha pajisjet e tjera që bëjnë foto.
- **Shprehni shqetësimet kujdestarëve tuaj në një mënyrë me respekt** (nëse ju duhet më tepër ndihmë ose jeni të nxehur për kujdesin tuaj, një avokat pacienti mund t'ju ndihmojë).
- Kufizimet e justifikuar klinike mbi të drejtat e vizitave mund të caktohen nga spitali.

Për të Parashtruar një Ankesë për Kujdesin Tuaj, Mund të Kontaktoni:

Zyrën e Avokatëve të Pacientit

Saint Vincent Hospital
123 Summer Street
Worcester, MA 01608-1320
508-363-6308

Komisioni i Godinës

Spektori i Veprimeve të Akreditimit
1 Renaissance Boulevard
Oakbrook Terrace, IL 60181
800-994-6610

Email: complaint@jointcommission.org

Departamenti i Shëndetit Publik

Spektori i Cilësisë të Kujdesit Mjekësor
99 Chauncey Street, 2nd Floor
Boston, MA 02111
800-462-5540

Shteti i Masaçusetsit

Bordi i Regjistrimit në Mjekësi
200 Harvard Mill Square, Suite 300
Wakefield, MA 01880
781-876-8200



SAINT VINCENT HOSPITAL

Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Pacientit

Faleminderit që morët kohën për të lexuar këtë Dëshminë e të Drejtave të Pacientit Nëse doni një kopje të plotë të Dëshmisë të të Drejtave të Pacientit ose doni të diskutoni mbi këto të drejta dhe përgjegjësi, ju lutem telefononi Avokatët e Zyrës të Pacientit në 508-363-6308, ose shtesën (në-shtëpi).

Nëse ju duhet një përkthim i këtij dokumenti, ju lutem telefononi Shërbimet e Interpretimit në 508-363-8695, ose shtesën (në-shtëpi) 28695.

Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Pacientit

Spitali Saint Vincent dhe krejt stafi i tij respekton të drejtat tuaja si pacient, duke ju njohur si një individ me nevoja unike shëndeti. Qëllimi ynë është që t'ju japim kujdesin e duhur për sëmundjen tuaj dhe t'ju ndihmojmë të shërohemi sa më parë të jetë e mundur.

Të drejta dhe përgjegjësitë në vijim janë një përmbledhje e të drejtave tuaja nën Ligjin Massachusetts Law MGL Kapitulli 111, pjesa 70E, e quajtur **Dëshmia e të Drejtave të Pacientit**, dhe standardet e Komisionit të Përbashkët mbi Akreditimin e Organizatave të Kujdesit për Shëndetin. Duke ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja, na ndihmoni t'ju japim kujdesin më të mirë ndërkohë që jeni në spital.

Këto Janë të Drejtat Tuaja

- **Keni të drejtën të trajtoheni në një mënyrë të kujdeshme dhe me respekt dhe të keni akses të paanshëm në mjekim ose akomodim** që është i disponueshëm ose që tregohet në mënyrë mjekësore, pavarësisht racës, fesë, vlerave kulturore/personale, besimeve dhe preferencave, prejardhjes etnike, gjuhës, paaftësive fizike ose mendore, seksit, orientimit seksual, identitetit ose shprehive të gjinisë, moshës, statusit socio-ekonomik ose aftësive për të paguar shërbimet.
- **Keni të drejtën të dini emrat** e njerëzve që po kujdesen për ju dhe si do t'ju ndihmojnë juve ata apo ofrojnë kujdes mjekësor për ju. Kjo është gjithashtu e vërtetë nëse po kujdeseni nga studentë, mjekë rezidentë ose njerëz të tjerë në trajnim.
- **Keni të drejtën të refuzoni që të mos vëzhgoheni, ekzaminoheni ose mjekoheni pa vënë në rrezik mundësinë tuaj për tu mjekuar.** Kjo është gjithashtu e vërtetë nëse po mjekoheni nga studentë, mjekë rezidentë, ose njerëz të tjerë në trajnim.
- **Keni të drejtën të krijoni një autorizim të avancuar për kujdesin për shëndetin**, e cila i tregon spitalit dhe mjekut që doni që të marrë vendime për ju nëse ndodh që të mos jeni në gjendje të merrni vendime vetë. Pas pranimit, nëse tashmë keni një direktivë të avancuar ju lutem jepini spitalit një kopje e cila do të vendoset në regjistrimet tuaja mjekësore.
- **Keni të drejtën të rishikoni autorizimin tuaj të kujdesit për shëndetin.**
- **Keni të drejtën të merrni vendime të informuara** në lidhje me kujdesin tuaj mjekësor, përfshirë:
 - *Të qenit i informuar për gjendjen tuaj të shëndetit.
 - *Të qenit i përfshirë në planifikim dhe mjekim të kujdesit shëndetësor.
 - *Të qenit i aftë për të kërkuar ose refuzuar mjekimin.
- **Keni të drejtën të merrni pjesë në vendime** për mjekimin ose shërbimet e shëndetit.

- **Keni të drejtën të merrni pjesë ose të thoni jo** nëse nuk doni të merrni pjesë në këtë studim, investigim, dhe eksperimente klinike pa vënë në rrezik mundësinë tuaj për tu mjekuar.
- **Keni të drejtën të merrni këtë konsultim etikash** e cila është e disponueshme për t'ju ndihmuar juve dhe familjen tuaj në marrjen e vendimeve etike.
- **Keni të drejtën të merrni këtë mjekim që ju shpëton jetën** pa diskriminim për shkak të gjendjes tuaj ekonomike ose burimit të pagesës.
- **Keni të drejtën, nëse vuani nga ndonjë formë e kancerit të gjirit**, të plotësoni informacionet mbi të gjitha mjekimet alternative që janë të pranueshme nga ana mjekësore.
- **Keni të drejtën e konfidencialitetit për të gjitha regjistrimet dhe komunikimet** në lidhje me historinë tuaj mjekësore dhe mjekimin deri në shkallën e caktuar nga ligji.
- **Keni të drejtën e dinjitetit personal, dhe, deri në shkallën e mundshme e të arsyeshme, të drejtën e privatësisë gjatë trajtimit mjekësor dhe kujdesit jetës.**
- **Keni të drejtën e një përgjigje të shpejtë** për të gjitha kërkesat e arsyeshme.
- **Keni të drejtën të jepni ose refuzoni aprovimin tuaj** deri në shkallën e lejuar nga ligji.
- **Keni të drejtën të merrni këtë informacion** në lidhje me asistencën financiare dhe kujdesin falas dhe të kërkonte një faturë të detajuar që pasqyron tarifat nga mjeku dhe/ose spitali.
- **Keni të drejtën të merrni një kopje të çdo norme ose rregulli të këtij spitali** që mund t'i aplikohet drejtimit tuaj si pacient.
- **Keni të drejtën që me kërkesë të inspektioni regjistrimet tuaja mjekësore, të kërkonte një amendament, ose të merrni një llogaritje të zbulimeve në lidhje me informacionet e shëndetit personal**, dhe për një tarifë të arsyeshme, të merrni një kopje të regjistrimeve tuaja.
- **Keni të drejtën të merrni një kopje të regjistrimeve tuaja mjekësore falas** nëse tregoni që kërkesa juaj është për të mbështetur një pohim ose apelim nën çdo dispozitë të Aktit të Sigurisë Sociale në çdo program me bazë në nevojat financiare të shtetit ose federatës.
- **Keni të drejtën e sigurisë personale dhe një ambient të sigurt** ndërkohë që jeni në Saint Vincent Hospital.
- **Keni që dhimbja juaj të menaxhohet.**
- **Keni të drejtën e një komunikimi të efektshëm dhe të drejtën të merrni informacion** në një mënyrë që e kuptoni.

- **Keni të drejtën të shprehni lirshëm dhe hapur shqetësimet ose ankesat tuaja** kur cilësia e kujdesit ose shërbimeve që merrni nuk përputhet me atë që prisni ju. Nëse bëni një ankesë, në asnjë mënyrë nuk do të ndikohet kujdesi juaj. Gjithashtu, nëse keni një problem që nuk mund ta zgjidhni me mjekun tuaj, infermieren, Menaxherin e Departamentit, ose ose kujdestarë të tjerë, mund të kontaktoni Zyrën e Avokatëve të Pacientit në 508-363-6308,
- **Keni të drejtën të informoheni** në lidhje me shtrirjen në të cilën spitali është në gjendje, është i gatshëm dhe/ose nuk mund të respektojë direktivat e avancuara mbi trajtimet mjekësore ose procedurat e çdo lloji ku ofertat e spitalit nuk janë në përputje me vlerat dhe etikën e tij.
- **Keni të drejtën të kërkonte njoftim të familjes tuaj dhe/ose Mjekut Tuaj Kryesor** për pranimin në spital.
- **Keni të drejtën të pranoni ose refuzoni trajtime mjekësore ose kirurgjikale**, përfshirë heqjen dorë ose tërheqjen nga mjekimet që ruajnë jetën ose të refuzoni shërbimet ringjallëse.
- **Keni të drejtën të kërkonte informacion në lidhje me marrëdhëniet e spitalit me komplekse të tjera shëndeti**, nëse ka.
- **Keni të drejtën të jepni ose refuzoni aprovimin tuaj** të prodhoni ose përdorni regjistrime, filmime, ose imazhe të tjera të vetes tuaj për qëllime të tjera përveç atyre të kujdesit shëndetësor.
- **Keni të drejtën të jeni të lirë nga pakujdesia, shfrytëzimi, ose çdo lloj tjetër abuzimi ose ngacmimi.**
- **Keni të drejtën të keni shërbime mbrojtëse dhe avokative.**
- **Keni të drejtën të merrni vizitorët që përcaktoni** që përfshijnë, megjithëse jo vetëm këta: nusja, partneri i shtëpisë (përfshirë partnerin me të njëjtin seks), një anëtar tjetër i familjes ose një mik.
- **Keni të drejtën të tërhiqni ose refuzoni aprovimin për vizita** në çdo kohë.
- **Keni të drejtën një individ që t'ju ndihmojë sipas zgjedhjes tuaj** prezent për mbështetje emocionale gjatë qëndrimit tuaj, përveçse në rast se prania e tij ndërhyr në të drejtat e të tjerëve ose është diçka negative nga ana mjekësore ose terapeutike.
- **Të gjithë vizitorët e përcaktuar nga ju** (një person që ju mbështet) do të gëzojë privilegjet e vizitave që janë as më pak as më shumë kufizuese se ato të drejta që zotërojnë anëtarët e familjes.